



## **SYLLABUS I LËNDËS “SILVIKULTURA 1”**

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti i Shkencave të Jetes dhe Mjedisit</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Silvikultura 1</b>
<b>Programi:</b>	<b>Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Bachelor</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>Viti i dytë , semestri i parë</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>3+2</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>6</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>Do shpallet</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof.Asoc.Dr. Mirvjena Kellezi</b>
<b>Të dhënat kontaktuese:</b>	<b>mirvjena.kortoci@uni-prizren.com</b>
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	<p>Silvikultura 1 synon të informojë studentet mbi rolin dhe rendesine e pyjeve në nivel global. Roli fiziko-gjeografik i pyjeve (roli edafik, gjeomor-follogjik, klimatik e hidrologjik). Roli antropo-gjeografik i pyjeve (roli si prodhues i lendeve të para. Ndikimi i pyjeve mbi kulturat bujqesore e blegtorine, roli higjienik dhe estetik i pyjeve. Rreziqet e ekosistemeve pyjore sot në bote.</p> <p>Pylli si bashkesi jetese komplekse (ekosistemi pyjor). Druret si karakteristike e grumbujve pyjore. Dallimet midis drureve të vetmuar dhe atyre të rritur në pyll.</p> <p>Tiparet kryesore të ekosistemeve pyjore. Elementet perberes të tyre. Grumbulli pyjor (drunishtja) si kati kryesor i pyllit. Katet e tjera të pyllit (nendrunishtja, filizeria dhe shtresa barishtore. Tiparet strukturore të grumbullit pyjor.</p> <p>Klasifikimi i drureve në grumbujt pyjorë sipas rritjes (klasifikimi sipas KRAFT-it dhe IUFRO-s). Klasat e prodhimit dhe cilesise se grumbujve pyjore.</p> <p>Funksionet vegjetative ose fazat fenologjike të drureve. Fazat e zhvillimit të drureve e grumbujve pyjore.</p> <p>Kushtet e formimit në natyrë të grumbujve të thjeshtë ose të perzier. Avantazhet dhe disavantazhet e grumbujve të thjeshtë e të perzier. Perberja, zhvillimi dhe struktura e grumbujve pyjore.</p> <p>Roli dhe detyrat e silvoteknikes. Çlirimet dhe pastrimet. Qellimet e përgjithshme silvikulturore, realizimi teknik dhe periodiciteti i çlirimeve dhe pastrimeve.</p> <p>Rrallimet e shkallës së parë dhe të shkallës së dytë. Qellimet e përgjithshme silvikulturore, realizimi teknik dhe periodiciteti i rrallimeve. Klasifikimi i drureve në kuadrin e rrallimeve.</p>

	<p>Metodat e ndryshme per zbatimin e prerjeve kulturore. Format e qeverisjes dhe tipet e trajtimit te grumbujve pyjore. Trajtimi me prerje rrah ne siperfaqe te medha dhe siperfaqe te vogla. Karakteristikat kryesore, objektivat silvikulturore, vleresimi ekologjik e silvikulturor i trajtimit. Perparesite dhe te metat e trajtimit me prerje rrah.</p> <p>Trajtimi me prerje te njembasnjeshme (suksesive) uniforme. Karakteristikat, objektivat, ecuria e trajtimit dhe vleresimi ekologjik i tij. Perparesite dhe te metat e trajtimit me prerje te njembasnjeshme uniforme.</p> <p>Trajtimi me prerje te njembasnjeshme jouniforme (progresive ose ne çeltira). Karakteristikat, objektivat, ecuria e trajtimit dhe vleresimi ekologjik i tij. Anet pozitive dhe negative te trajtimit me prerje te njembasnjeshme jo uniforme.</p> <p>Trajtimi me prerje suksesive uniforme ne skaj te masivit. Qellimi dhe teknika e ripërteritjes, vleresimi ekologjik-silvikulturor. Anet pozitive dhe negative te trajtimit me prerje te njembas-njeshme uniforme ne skaj te masivit.</p> <p>Tipe te tjera te trajtimit te pyllit. Trajtimi me prerje te vazhdueshme (kopshtore) dhe trajtimi me prerje me diameter kufi. Vleresimi silvikulturor i ketyre trajtimeve.</p> <p>Koncepte te reja ne qeverisjen e pyjeve. Silvicultura natyralistike. Koncepti i „Shfrytezimit ekologjik te pyjeve”. Silvicultura dhe “Çertifikimi i pyjeve”.</p>
<p><b>Qëllimi i lëndës:</b></p>	<p>Qellimi i lendes se Silvilkultures 1 eshte te evidentoje faktoret ekologjike qe ndikojne ne jeten e pyllit dhe mundesite e modifikimit te tyre me masa tendryshme silvikulturore;</p> <p>Biologjine e pyllit (silvobiologjia). Njohuri te pergjitheshme mbi pyllin. Pylli si bashkesi jetese komplekse (ekosistemi pyjor). Tiparet kryesore te ekosistemeve pyjore.</p> <p>Ligjet e suksesionit e te evolucionit te bimesise pyjore si dhe mundesite e drejtimit te tyre;</p> <p>Shperndarja e bimesise ne bote dhe sistemet e klasifikimit te pyjeve. Zonat fitoklimatike dhe formacionet pyjore kryesore te vendit tone sipas zonave fitoklimatike.</p> <p>Punimet e kujdesimit ne grumbujt pyjore dhe premiset ekonomiko-biologjike te tyre.</p> <p>Metodat e kryesore per zbatimin e punimeve te kujdesimit dhe zbatimi konkret i tyre ne formacionet kryesore pyjore te vendit tone.</p>



	<p>Format kryesore te qeverisjes dhe tipet me te rendesishme te trajtimit te grumbujve pyjore dhe zbatimi i tyre ne formacionet kryesore te vendit te tone.</p> <p>Koncepte te reja ne qeverisjen e qendrueshme te pyjeve. Silvicultura natyralistike. Koncepti i „Shfrytezimit ekologjik te pyjeve” dhe “Çertifikimi i pyjeve”.</p>		
<b>Rezultatet e të nxënit:</b>	<p>Pas perfundimit te ketij kursi studenti duhet te jene ne gjendje te:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Identifikoje faktoret ekologjike dhe biologjike dhe nderhyrjet ne pyll me masa te ndryshme silvikulturore;</li> <li>2. Te shpjegoje ligjet e suksesionit e te evolucionit te bimesise pyjore si dhe mundesite e drejtimit te tyre;</li> <li>3. Te percaktoje zonat fitoklimatike dhe formacionet pyjore kryesore te vendit sipas zonave fitoklimatike.</li> <li>4. Te kategorizojë metodat e kryesore te zbatimit te punimeve te kujdesimit ne formacionet kryesore pyjore te vendit.</li> <li>5. Te kombinoje format kryesore te qeverisjes dhe tipet me te rendesishme te trajtimit te grumbujve pyjore dhe zbatimi i tyre ne pyll.</li> </ol>		
<b>Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mesimdhënesin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në terren	1	15	15
Kollokfiume, seminare	2	-	2
Detyra të shtëpisë	-	-	-
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuis, provim final)	2	5	10
Projektet, prezantimet ,etj	3	-	3
<b>Totali</b>			<b>150 orë</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata, diskutime, ushtrime laboratorike, ekspedita konsultime, seminare, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kolokviume, detyre kursi, provime.		
<b>Metodologjia e vlerësimit:</b>	Vlerësimi i parë (kolokvium): 10%, Vlerësimi i dytë (kolokvium): 10%, Seminaret ose angazhime të tjera: 10%,		



	Provimi final: 70%, Total: 100%.
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura primare:</b>	Tabaku, V. (2015): Bazat e Silvikultures. Leksione te shkruara per studentet. Kortoçi, Y., Kellezi, M. (2012): Shfrytezimi i pyjeve te ahut te Shqiperise me nje silvikulture te qendrushme.
<b>Literatura shitesë:</b>	Mine, V., Postoli, A., Tabaku, V. (2002): Rrallimet tregtare ne grumbujt pyjore. Tiranë. Marku, V. (2014): Dendrologjia Ralph D. Nyland: Silviculture: Concepts and Applications, 2007.

<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>		
<b>Java</b>	<b>Ligjërata</b>	<b>Ushtrime</b>
<i>Java e parë:</i>	<p>Objekti dhe qellimi i silvikultures. Historia e zhvillimit te saj ne bote. Detyrat e qellimet e aktiviteteve silvikulturore ne vendin tone.</p> <p>Roli dhe rendesia e pyjeve ne nivel global. Roli fiziko-gjeografik i pyjeve (Roli edafik, gjeomorfollogjik, klimatik dhe hidrologjik). Roli anthro-po-gjeografik i pyjeve (si prodhues i lendeve te para. Ndikimi i pyjeve mbi kulturat bujqesore e blegtorine, roli higjenik e estetik i pyjeve. Rreziqet e ekosistemeve pyjore sot ne bote.</p> <p>Biologjia e pyllit (silvobiologjia). Njohuri te pergjitheshme mbi pyllin. Pylli si bashkesi jetese komplekse (ekosistemi pyjor). Druret si karakteristike e grumbujve pyjore. Dallimet midis</p>	Demonstrime ne pyll mbi metodat e pershkrimit te grumbujve pyjore.

	drureve te vetmuar dhe atyre te rritur ne pyll.	
<i>Java e dytë:</i>	<p>Tiparet e ekosistemeve pyjore. Elementet perberes te tyre. Grumbulli pyjor (drunishtja): kati kryesor i pyllit. Katet e tjere te pyllit (nenpylli, filizeria dhe shtresa barishtore.</p> <p>Klasifikimi i drureve ne grumbujt pyjorë sipas rritjes (klasifi-kimi sipas KRAFT-it dhe IUFRO-s). Klasat e prodhimit dhe cilesise se grumbujve pyjore.</p>	Praktike ne pyll mbi pershkrimin e tipareve strukturore te grumbujve: orgjina, perberja, kurordendesia, struktura horizontale/vertikale.
<i>Java e tretë:</i>	<p>Mardheniet midis pyllit dhe mjedisit. Njohuri te pergjithesh-me mbi ekologjine pyjore. Grupet e faktoreve ekologjike, mekanizmi i ndikimit te tyre ne jeten e pyllit.</p> <p>Bimesia pyjore dhe faktoret klimatik. Elementet e atmosferes si faktore ekologjik. Drita e nxehtesia si faktor ekologjik. Ndi-kimi i tyre ne jeten e pyllit dhe ndikimi i pyllit mbi to. Konkluzione silvikulturore lidhur me driten dhe nxehtesine.</p> <p>Lageshtia dhe era si faktor ekologjik. Ndikimi i tyre ne jeten e pyllit dhe ndikimi i pyllit mbi to. Mundesite e ndryshimit te tyre me masa silvikulturore. Konkluzione silvikulturore.</p>	Praktike ne pyll mbi klasifikimin e drureve sipas (sipas Kraft dhe IUFRO). Menyrat e percaktimit te klasave te prodhimit dhe cilesise.
<i>Java e katërt:</i>	<p>Bimesia pyjore dhe faktoret edafike. Elementet kimik te tokes si faktor ekologjik. Ndikimi i tokes ne jeten e pyllit. Regjimi i lageshtise,</p>	Praktike ne pyll per percaktimin e fazave natyrore te zhvillimit te grumbullit pyjor.

	<p>trofik, i ajrosjes dhe i nxehtesise se tokave pyjore. Ndikimi i pyllit mbi token. Konkluzione silvikulturore. Bimesia pyjore dhe faktoret topografike. (altituda, pjerrsia dhe kundrejtimi). Bimesia pyjore dhe faktoret biotike. Faktoret biotike bimore e shtazore. Roli i njeriut ne jeten e pyllit. Rendesia e njohurive ekologjike.</p>	
<i>Java e pestë:</i>	<p>Biologjia e drureve pyjore. Funkcionet vegjetative /fazat fenologjike te tyre. Rritja e drureve (rritja ne lartesi, diameter dhe ne vellim). Fazat e zhvillimit te drureve e grumbujve pyjore. Njohuri mbi grumbujt pyjore. Kushtet e formimit ne natyre te grumbujve te thjeshte e te perzier. Avantazhet dhe disavantazhet e grumbujve te thjeshte e te perbere. Perberja, zhvillimi dhe struktura e grumbujve pyjore. Evolucioni i pyllit dhe ligjet e suksesionit te tij. Vlera kulturore dhe ekonomike dhe rendesia e njohjes se suksesioneve.</p>	<p>Demonstrime dhe diskutime mbi perparesite dhe te metat e grumbujve pyjore te perzier dhe te thjeshte</p>
<i>Java e gjashtë:</i>	<p>Shperndarja e bimesise ne bote dhe Shqiperi. Sistemet e klasifikimit te pyjeve. Zonat fitoklimatike dhe formacionet pyjore kryesore te vendit sipas zonave fitoklimatike. Njohuri mbi tipologji pyjore. Roli dhe kontributi i silvoteknikes ne intensifikimin e prodhimitarise se grumbujve pyjore.</p>	<p>Praktike ne pyll mbi pershkrimin e formacioneve pyjore dhe zonave fitoklimatike.</p>

	Perse drejtim silvikulturor te pyllit? Qellimet dhe metodat e planifikimit silvikulturor.	
<i>Java e shtatë:</i>	Struktura dhe rigjenerimi ne pyjet e virgjër. Metodot e studimit ne grumbujt e virgjër dhe ne rezervatet natyrore. Teoria e fazave natyrore te zhvillimit ne grumbujt pyjore. Punimet e kujdesimit ne grumbujt pyjore. Bazat teorike te tyre. Kujdesi per filizerine, gemushajen dhe grumbullin e ri. Prerjet kulturore. Premisat ekonomike e biologjike te prerjeve kulturore. Çlirimet dhe pastrimet. Qellimet e pergjitheshme silvikulturore, realizimi teknik dhe periodiciteti i çlirimeve e pastrimeve.	Demonstrime mbi metodiken e punes ne punimet tipologjike pyjore.
<i>Java e tetë:</i>	Rrallimet e shkalles se pare dhe te shkalles se dyte. Qellimet e pergjitheshme silvikulturore, realizimi teknik dhe periodiciteti i rrallimeve. Klasifikimi i drureve ne kuadrin e rrallimeve. Metodot e zbatimit te prerjeve kulturore. Metodot e zbatimit te çlirimeve e pastrimeve. Metodot klasike te zbatimit te rrallimeve (rrallimi nga poshte, nga lart, i kombinuar dhe me te zgjedhur. Metodot e reja te rrallimeve (rrallimi kopshtor, me diameter kufi, ne grupe, gjeometrik ne plantazhet pyjore).	Seminari 1: Rendesia dhe funksionet kryesore te pyjeve per shoqerine njezore dhe faktoret kryesore ekologjike qe ndikojne ne jeten e pyllit.
<i>Java e nëntë:</i>	Zbatimi i prerjeve kulturore ne formacionet kryesore pyjore. Punime te tjera	Konkretizime dhe ilustrime praktike ne pyll mbi mjetet dhe realizimin

	<p>kujdesimi. Krasitjet e degeve. Prerjet higjeno-sanitare. Mjetet dhe teknika e realizimit te tyre.</p> <p>Format e qeverisjes dhe tipet e trajtimit te grumbujve pyjore. Qeverisja si trungshte. Trajtimi me prerje rrah ne siperfaqe te medha dhe te vogla. Perparesite dhe te metat e trajtimit me prerje rrah.</p> <p>Trajtimi me prerje te njembasnjeshme (suksesive) uniforme. Karakteristikat, objektivat, ecuria e trajtimit dhe vleresimi ekologjik i tij. Perparesite dhe te metat e trajtimit.</p>	<p>teknik te çlirimeve dhe te pastrimeve ne grumbujt pyjorë.</p>
<p><i>Java e dhjetë:</i></p>	<p>Trajtimi me prerje suksesive jouniforme (progresive ose me çeltira). Karakteristikat, objektivat, ecuria e trajtimit dhe vleresimi ekologjik i tij. Anet pozitive dhe negative te trajtimit.</p> <p>Trajtimi me prerje suksesive uniforme ne skaj te masivit. Qellimi dhe teknika. Vleresimi silvikulturor. Anet pozitive e negative te trajtimit.</p>	<p>Demonstrim praktik ne pyll mbi mjetet dhe realizimin teknik te rrallimeve ne grumbujt pyjorë. Rrallime nga lart dhe nga poshte.</p>
<p><i>Java e njëmbëdhjetë:</i></p>	<p>Tipe te tjera te trajtimit te pyllit. Trajtimi me prerje te vazhdueshme (kopshtore) dhe trajtimi me prerje me diameter kufi. Vleresimi silvikulturor i ketyre trajtimeve.</p> <p>Qeverisja si pyll i mesem dhe si pyll i ulet. Format dhe llojet e riparteritjes ne pyjet e ulet te dushqeve.</p>	<p>Demonstrim praktik mbi zbatimin e prerjeve suksesive uniforme</p>



	Trajtimi i cungishtes se thjeshte dhe i cungishtes me amësore. Teknikat e zbatimit te saj ne vendin tone.	
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Trajtimi i cungishtes kopshtore. Teknika e realizimit te saj. Regjimi i cungishtes se perbere (riperteritja me fare dhe me lastare).	Demonstrim praktik mbi zbatimin e prerjeve suksesive jouniforme.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Riperteritja vegjetative e pyllit. Pylli i mesem. Trajtime me prerje nga lart. Prerja ne trungore. Transformimi i pyllit te ulet dhe ne pyll te larte. Konversioni dhe format e tij. Konversioni me riperteritje natyrore dhe artificiale	Demonstrime praktike te damkimit ne pyje. Aspektet silvikulurore.
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Rendesia kulturore dhe ekonomike e riperteritjes natyrore dhe artificiale. Zgjedhja e trajtimit per nje grumbll pyjor. Format e qeverisjes dhe tipet e trajtimeve ne formacionet pyjore kryesore te vendit tone.	Zbatimi i regjimeve dhe i trajtimeve ne pyjet e ulet (cungishtet).
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Koncepte te reja ne qeverisjen e qendrueshme te pyjeve. Silvikultura natyralistike. Koncepti i „shfrytezimit ekologjik te pyjeve”. Silvikultura dhe “Çertifikimi i pyjeve”.	Seminar 2: Punimet e kujdesimit ne grumbujt pyjore, format e qeverisjes si dhe llojet e trajtimeve te tyre
<b>Politikat akademike dhe kodi i sjelljes</b>		
<p>Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjërata, marrin pjese ne vizita studimore ne terren(ekskursion). Shkyçja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimit dhe mbajtja e qetësisë në mësime po ashtu janë obligative.</p>		